



Financuar nga
Bashkimi Evropian

MANUALI PËR MBLEDHJE TË FONDEVE

Mars 2023



OFAP®
Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror



Ky manual është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e konsorciumit të udhëhequr nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.

Manuali për Ngritje të Fondeve është prodhuar në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizimin”, financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës, Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror OFAP dhe KMOP.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE	5
1. NGRITJA/MBLEDHJA E FONDEVE	5
2. ZHVILLIMIT TË PARTNERITETIT INSTITUCIONAL ME AGJENSIONET/ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE NË VEND	6
3. PARTNERITETI ME BIZNESE, FONDACIONE DHE INDIVIDË ME NETO TË LARTË - VLERAT DHE PARIMET UDHËZUESE TË PARTNERITETIT ME BIZNESE, FONDACIONE DHE INDIVIDË	7
3.1 KOMF bashkëpunon me partnerë që ndajnë të njëjtat vlera.	8
3.2 Parimet udhëzuese të partneritetit me bizneset, fonacionet dhe individët me neto të lartë	8
3.2.1 Kufizim i plotë i partneritetit	9
3.2.2 Partneritet i kujdesshëm	10
3.3 Ekskluziviteti me partnerë	11
3.4 Marrëveshjet e partneritetit/pranimit të donacionit	12
4. PARIMET UDHËZUESE TË MBLEDHJES SË DONACIONEVE NGA INDIVIDËT	13
5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	14
Bordi i KOMF	14
Ekipi i KOMF	14
6. UDHËZIME PRAKTIKE	15
6.1 Hapat në mbledhje të fondeve nga bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë dhe individët	16
6.2 Etika në raport me Donatorët/partnerët – përdorimi i të dhënave	16

Përmbledhje

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në Qershor të vitit 2011, është një koalicion i përbërë nga 34 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Misioni i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve është mbrojtja, respektimi, mirëqenia dhe avancimi i të drejtave të fëmijëve. Kjo realizohet nëpërmjet lobimit dhe avokimit për promovimin dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve sipas KDF-së.

Për të realizuar misionin e tij për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, KOMF ka hartuar tashmë strategjinë për mbledhje të fondeve dhe vullnetarizëm me qëllim të ngritjes së qëndrueshmërisë së vetë koalicionit por edhe anëtarëve të tij. Përkundër nevojës së lartë për qëndrueshmëri financiare, jo vetëm të koalicionit por edhe anëtarëve të tij, është parë e nevojshme të hartohet një manual për ngritje të fondeve përmes të cilit do të vendosen parimet bazë, standardet dhe udhëzimet e partneritetit me sektorin e bizneseve, individëve dhe fondacioneve.

Parimi kyç i koalicionit është që do të hyjë në partneritetet vetëm me bizneset, individët dhe fondacionet, puna dhe veprimtaria e të cilëve nuk është në kundërshtim me misionin, vizionin, parimet e koalicionit si dhe me të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijëve. KOMF do të punojë vetëm me partnerë të cilët ndajnë të njëjtat vlera në mbrojtjen dhe interesin më të mirë të fëmijëve.

KOMF të gjithë donatorët qofshin ata individë, biznese apo fondacione do t'i trajtojë me respekt, kurajo dhe do të jetë transparent në mbajtjen e raporteve me donatorë. Po ashtu në vazhdimësi do të investojë në aktivitete për mbledhjen e fondeve dhe do të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të organizatave anëtare në mbledhje të fondeve duke i ndarë përvojat dhe njohuritë e koalicionit me anëtarët e tij.

1. Ngritja/mbledhja e fondeve

Përmes mbledhjes së fondeve kuptojmë veprimet e ndërmarra për të mbledhur fonde, përmes së cilave do të mbështeten aktivitetet në përmbushjen e misionit të KOMF. Mbledhja e fondeve është procesi i kërkimit dhe mbledhjes së kontributeve financiare në para apo burimeve tjera duke kërkuar donacione nga individët, bizneset, fondacionet, agjensitë ndërkombëtare, qeveritë, etj.

Përmes mbledhjes së fondeve në:

- Sigurojmë burimet e nevojshme dhe ngremë qëndrueshmërinë financiare të KOMF dhe anëtarëve të tij;
- Sigurojmë burimet e nevojshme financiare, në të mira materiale apo shërbime për të përkrahur programet, aktivitetet dhe shpenzimet e KOMF apo të organizatave anëtare;

- Jemi partnerë kyç me agjensitë ndërkombëtare, bizneset, fondacionet dhe individët për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve;
- Promovojmë dhe ndërgjegjësojmë publikun e gjerë për rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve në vend
- Rrisim kanalet e komunikimit për mbrojtje dhe të drejta të fëmijëve;
- Krijojmë një bazë të gjerë të përkrahësve të të drejtave të fëmijëve në vend;
- Ruajmë besueshmërinë e KOMF për mbrojtje të fëmijëve;
- Ruajmë integritetin dhe pavarësinë e KOMF.

Për të krijuar qëndrueshmërinë financiare, KOMF do të synojë diversifikimin e fondeve duke ngritur fondet përmes:

- Zhvillimit të partneritetit institucional me agjensitë/donatorët ndërkombëtare në vend;
- Partneritetit me biznese;
- Partneritetit me fondacione (tek fondacionet përfshihen edhe fondacionet e themeluara nga korporatat, fondacionet e familjeve etj.);
- Donatorëve individual me neto të lartë (janë donatorët, filantropët të cilët donacionin e tyre e bëjnë në emrin e tyre individual dhe mund të donojnë nga 1500 euro e më shumë brenda vitit)
- Donatorëve individual (donatorët individual të cilët donojnë në mënyrë sporadike apo rregullisht vlera të ulëta)

2. Zhvillimit të partneritetit institucional me agjensitë/organizatat ndërkombëtare në vend

Zhvillimi i partneritetit institucional është procesi i krijimit të partneritetit me dhe aplikimi për fonde me donatorët institucional (agjensitë qeveritare ndërkombëtare/organizatat ndërkombëtare, ambasadat etj.) për KOMF apo për KOMF dhe anëtarët e saj.

Donatorët institucional zakonisht i kanë të përcaktuara prioritetet dhe fushat e projekteve të cilat ata i financojnë në mënyrë që të arrijnë objektivat e tyre. Ekzistojnë disa mënyra të partneritetit dhe proceseve të marrjes së fondeve nga donatorët institucional sikurse: donatori fton organizatën për të aplikuar për realizimin e një programi, donatori hap thirrjen për aplikim.

KOMF do të realizojë takime të vazhdueshme me donatorët institucional për të ngritur çështjet e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve dhe do të synojë që të ketë partnerë të cilët do ta mbështesin KOMF por edhe anëtarët e tij në avancimin e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve. Po ashtu KOMF do të aplikojë në mënyrë të vazhdueshme në thirrjet të cilat janë në fushën dhe misionin e KOMF si e vetme, si bashkë-aplikues me organizatat anëtare apo si bashkë-aplikues me koalicionet dhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtje të fëmijëve.

3. Partneriteti me biznese, fondacione dhe individë me neto të lartë - Vlerat dhe Parimet udhëzuese të partneritetit me biznese, fondacione dhe individë

Partneriteti me biznese, fondacione dhe individë me neto të lartë do të bëhet duke i zbatuar vlerat, parimet dhe standardet e KOMF.

Vlerat e partneritetit me biznese, fondacione dhe individë me neto të lartë janë:

1. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe interesit më të mirë të fëmijëve;
2. Gjithpërfshirja e fëmijëve për qasje në shërbimet sociale, arsimore dhe shëndetësore;
3. Uniteti dhe gatishmëria e KOMF dhe organizatave anëtare për të punuar për interesin më të mirë të fëmijëve;
4. Përkushtimi dhe ndërgjegjësimi për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve;
5. Partneritet i qëndrueshëm në mbrojtje të fëmijëve.

Parimet e partneritetit me biznese, fondacione dhe individë janë:

1. Transparenca dhe llogaridhënia;
2. Mbrojtja e integritetit dhe e konfidencialitetit të fëmijëve;
3. Mos – diskriminimi dhe gjithpërfshirja e fëmijëve;
4. Respektimi i vlerave të KOMF;
5. Vlerat e përbashkëta të KOMF dhe organizatave anëtare për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

Partneritet – me partneritet i referohemi raporteve të punës së krijuara me biznese, fondacione dhe individë me neto të lartë me të cilët do të punohet sipas misionit të KOMF dhe arritjes së objektivave në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve duke përfshirë kontributin e partnerëve në para të gatshme, donacione në shërbime apo të mira materiale drejtpërdrejt për KOMF apo përmes KOMF për anëtarët e saj.

Për të gjitha partneritetet me biznese, fondacione apo individë që do të arrihen për anëtarët e KOMF përmes partneritetit me KOMF, KOMF do të ndalë 25% të vlerës së donuar, për të mbuluar çështjet administrative të sekretariatit.

Në rastet kur fondet e mbledhura nga KOMF nga partneriteti me biznese, individë apo fondacione, tejkalojnë nevojat për zhvillimin e aktiviteteve të KOMF, atëherë pjesa e mbetur do të kalohet në fondet rezervë të KOMF.

Nëpërmjet angazhimit të ndërsjellët, bisedave të hapura dhe të përshtatura dhe marrëveshjeve për veprim, ne ofrojmë:

- arritjen e objektivave të përbashkëta të dakorduara dhe objektivat individuale organizative;
- mendim i përbashkët dhe qëllime ambicioze të përbashkëta për të dhënë ndikim;

- bashkëpunimi/jap dhe merr;
- komunikim i integruar dhe çiltërsi;
- administrimi.

KOMF synon që të hyjë në partneritet apo të pranojë donacione nga kompanitë/brendet, fondacionet, individët me neto të lartë, imazhi dhe përfaqësimi i të cilave është në pajtim me parimet, misionin dhe vlerat e KOMF dhe mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve. KOMF para pranimit të donacionit apo hyrjes në partneritet me biznese, fondacione apo individë me neto të lartë do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të vlerësuar me kujdes të shtuar (Due diligence) dhe për t'u siguruar që pranimi i donacionit apo partneriteti me biznesin/brendin, fondacionin apo individin në fjalë është në pajtim me parimet, misionin, vlerat KOMF si dhe manualin e KOMF mbi mbledhjen e fondeve. Edhe në rastet kur veprimtaria e biznesit, fondacionit apo individit nuk është në kundërshtim me parimet e manualit të mbledhjes së fondeve dhe të drejtat e fëmijëve, KOMF do të vlerësojë me kujdes ndikimin e pranimit të donacionit dhe partneritetit me brendin/biznesin, fondacionin apo individin.

Në rastet kur KOMF do të hyjë në partneritet afatmesëm apo afatgjatë (5 deri në 10 vite) me biznesin, fondacionin apo individin, vlerësimi me kujdes të shtuar (Due diligence) do të bëhet çdo 3 vite. Megjithatë në rast se biznesi, fondacioni apo individ gjatë kohës së marrëveshjes do të veprojë në kundërshtim me parimet e KOMF dhe të drejtat e fëmijëve, KOMF do të ndërpresë marrëveshjen dhe do të distancohet nga të gjitha veprimtaritë e biznesit, fondacionit apo individit.

3.1 KOMF bashkëpunon me partnerë që ndajnë të njëjtat vlera

KOMF do të kërkojë përkrahje nga bizneset, fondacionet dhe individët me neto të lartë të cilët besojnë në vlerat dhe parimet e KOMF, puna, produktet, imazhi dhe sjellja e të cilëve nuk është në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve. Detyra jonë ndaj donatorëve (përfshirë bizneset, fondacionet dhe individët) është puna drejt përmbushjes së misionit të KOMF për mbrojtje dhe të drejta të fëmijëve. Vetëm duke i respektuar vlerat tona dhe duke punuar drejt përmbushjes së misionit për mbrojtje të fëmijëve KOMF arrin që të mbrojë dhe ruaj reputacionin e saj. Prandaj kurdo që negociohet për pranim të një donacioni nga bizneset, fondacionet apo individët me neto të lartë, KOMF do të konsiderojë me kujdes ndikimin që pranimi i një donacioni të caktuar apo partneriteti i caktuar do të ketë në vlerat e KOMF, marrëdhëniet me publikun – imazhin e KOMF si dhe kontributin financiar.

3.2 Parimet udhëzuese të partneritetit me bizneset, fondacionet dhe individët me neto të lartë

Partneritetet vetëm me bizneset, fondacionet dhe individët me neto të lartë puna dhe veprimtaria e të cilëve nuk është në kundërshtim me misionin, vizionin, parimet e koalicionit si dhe me të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijëve. Përkundër synimit për të krijuar qëndrueshmëri financiare për KOMF dhe organizatat anëtare janë disa profile të kompanive, brendeve, produkteve dhe fondacioneve me të cilat KOMF nuk do të hyjë në partneritet dhe nuk do të pranojë donacione (në para të gatshme, të mira materiale apo shërbime).

KOMF nuk do të hyjë në partneritet me bizneset, fondacionet dhe individët, veprimet, produktet, brendet e të cilëve janë në kundërshtim me misionin dhe vlerat e KOMF si dhe

në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve dhe kur bashkëpunimi me ta do të mund të ndikojë negativisht mundësinë e KOMF për të vepruar të pavarur dhe për të vepruar dhe reaguar në mënyrë aktive për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

Duke patur parasysh që KOMF përfaqëson numrin më të madh të organizatave të cilat në fushëveprimin e punës së tyre kanë edhe mbrojtjen, të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve, KOMF nuk do të asociohet me biznese, fondacione apo individë të cilët janë të ndërlidhur me veprimet e tyre në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve, apo rrezikojnë në çfarëdo forme të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi. Ky parim nënkupton që KOMF do të pranojë donacione vetëm nga partnerët, bizneset, fondacionet dhe individët me neto të lartë veprimet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me të drejtat, mbrojtjen dhe interesin më të mirë të fëmijëve.

3.2.1 Kufizim i plotë i partneritetit

Duke patur parasysh se disa nga veprimtaritë e bizneseve, fondacioneve apo individëve me neto të lartë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve apo janë në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve dhe ligjet e vendit, dhe se shpeshherë disa nga bizneset përmes veprimtarive të tyre shkaktojnë dëme afatgjata tek fëmijët por edhe tek gjeneratat e ardhshme të fëmijëve kjo pjesë fokusohet tek kufizimi i plotë i pranimi të donacioneve apo hyrja në partneritet, pranimi të donacionit të njëhershëm (one off donation), donacionit të heshtur (silent donation) nga disa lloje të bizneseve, fondacioneve dhe individëve me neto të lartë.

KOMF nuk do të hyjë në partneritet, nuk do të pranojë donacione të asnjë forme dhe inkurajon edhe anëtarët e saj që të mos pranojnë donacione dhe të mos hynë në partneritet me biznese, fondacionet, individët me neto të lartë të cilët asociohen me kategoritë në vijim.

i. Shkelja e të drejtave të fëmijëve apo të drejtave të njeriut

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacion dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me biznese, fondacionet apo individët të cilët brenda 5 viteve të fundit janë akuzuar ose është dëshmuar që janë të përfshirë në shkelje të të drejtave të fëmijëve apo shkelje të të drejtave të njeriut dhe nuk respektojnë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.

ii. Shfrytëzimi (eksploatimi)

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacion dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me biznese, fondacionet apo individët me neto të lartë, të cilët akuzohen ose është dëshmuar që janë të përfshirë në shfrytëzimin e fëmijëve në punë, abuzimit seksual të fëmijëve, dhunën ndaj fëmijëve apo shkeljen e praktikave të punës sipas Deklaratës së ILO mbi parimet themelore dhe të drejtat në punë.

iii. Armët dhe pajisjet tjera të armatimit

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacione dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me biznese, fondacione e përfshira në prodhimin dhe distribuimin e armëve dhe pajisjeve të tjera të armatimit. KOMF nuk do të pranojë donacione dhe nuk do të hyjë në partneritet me biznese dhe fondacione që akuzohen apo është dëshmuar që mbështesin aktivitetet terroriste/paramilitare/guerile.

iv. Duhani dhe alkooli

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacione nga kompanitë (brendet) e duhanit (të çdo lloji të duhanit, cigare, cigare elektronike, etj.) dhe alkoolit apo kompanitë e tjera të cilat fitimin nga duhani apo alkooli brenda vitit e kanë mbi 40% të fitimit total të biznesit të tyre. Pragu i vendosur mbi 40% e lejon KOMF që të hyjë në partneritet me markete, supermarkete të cilat në mesin e produkteve të tyre kanë edhe duhan si dhe lejon KOMF që të hyjë në partneritet me korporata të mëdha të cilat përfaqësojnë brende serioze por që në kuadër të korporatës kanë edhe duhanin apo alkoolin.

v. Droga

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacion dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me bizneset, fondacione apo individë të cilët kanë të ardhura nga prodhimi dhe shitja ilegale e drogës (kokainës, MDMA/ekstasisë, GHB, halucinogjeneve, heroinës, metamfetamina). Përfshirë bënë bizneset legale – kompanitë farmaceutike të cilat janë të licencuara.

vi. Bixhoz – kazino

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacion dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me bizneset dhe fondacionet të cilat kanë mbi 15% të hyra brenda vitit fiskal nga bixhozi/kazinotë. Nga ky parim përjashtohen lotaritë e kauzës së mirë/bamirësisë. Për më shumë ju lutem referojuni definicionit të Asociacionit të lotarive të bamirësisë dhe listës së lotarive të bamirësisë në Bashkimin Evropian.

vii. Video lojërat e pa përshtatshme për fëmijët nën moshën 16 vjeçare

KOMF nuk do të pranojë dhe inkurajon edhe anëtarët që të mos pranojnë donacion dhe të mos hynë në asnjë formë të partneritetit me bizneset dhe fondacionet të cilat kanë mbi 40% të hyra brenda vitit fiskal nga video lojërat e pa përshtatshme për fëmijë të moshës nën 16 vjeçare.

3.2.2 Partneritet i kujdesshëm

KOMF do të trajtojë me kujdes para se të pranojë donacion apo të hyjë në partneritet, duke përfshirë pranimin e donacionit të njehershëm, donacionit të heshtur nga bizneset, fondacionet apo individët me neto të lartë të cilët janë të asociuar apo janë subjekt i perceptimit të përgjithshëm negativ të publikut. Kujdes të veçantë do t'i kushtohet pranimi të donacioneve apo partneritetit me bizneset, fondacionet për kategoritë në vijim dhe KOMF inkurajon edhe organizatat anëtare që të kenë kujdes të shtuar para hyrjes në partneritet apo pranimi të donacioneve nga bizneset dhe fondacionet nga kategoritë në vijim:

i. Dëmtimi i mjedisit

KOMF do të ketë kujdes, nuk do të pranojë donacione apo hyjë në partneritet me bizneset, fondacionet të cilët janë dënuar, akuzohen apo janë të përfshirë në dëmtim të ambientit. Megjithatë përjashtim nga ky parim bëjnë bizneset, fondacionet të cilat në 3 vitet e fundit dëshmojnë që kanë ndryshuar praktikat drejt mbrojtjes së ambientit dhe të cilat brenda 3 viteve të fundit nuk kanë qenë prezentë në media lidhur me imazhin negativ të ndotjes së ambientit.

ii. Korrupsion dhe shpëlarja e parave

KOMF do të ketë kujdes, nuk do të pranojë donacione apo hyjë në partneritet me bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë, të cilët janë dënuar për përfshirje në afëra të korrupsionit, zhvatje të parave apo/dhe shpëlarje të parave. Megjithatë përjashtim nga ky parim bëjnë bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë të cilat në 3 vitet e fundit dëshmojnë që kanë ndryshuar praktikën dhe të cilat brenda 3 viteve të fundit nuk kanë qenë prezentë në media lidhur me imazhin negativ të korrupsionit apo shpëlarjes së parave.

KOMF nuk do të pranojë donacion në para të gatshme nëse prejardhja e këtij donacioni është në kundërshtim me Ligjin NR. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit . Duke pas parasysh kapacitetet e kufizuara të KOMF për të hulumtuar thellësisht në të gjitha rastet, KOMF në marrëveshjen për donacion do të përfshijë një klauzolë apo deklaratë përmes së cilës biznesi, fondacioni apo individ i garanton që prejardhja e nuk është në kundërshtim me parimin 3.2.2 të këtij manuali dhe Ligjit Nr. 05/L-096.

iii. Llojet e tjera

KOMF do të trajtojë me kujdes të shtuar pranimin e donacionit apo partneritetin me sektorët e industrisë të cilat në periudhën e fundit kanë pasur tendencë të tërheqin vëmendjen e mediave përmes imazhit jo të mirë publik. Po ashtu KOMF do të trajtojë me kujdes të shtuar pranimin e donacionit apo partneritetin me partitë politike, grupet apo organizatat religjioze të cilat kanë tendencë të asociohen me praktika jo të mira dhe mund të asociohen me vëmendje negative të mediave dhe publikut. Në këto raste KOMF do të hulumtojë me kujdes të shtuar partnerët potencial para së të arrijë marrëveshje për pranim të donacionit apo para partneritetit.

Duke patur parasysh që KOMF është anëtar i organizmave ndërkombëtare dhe me qëllim të ruajtjes vlerave dhe imazhit të KOMF në raport me partnerët ndërkombëtarë, me kujdes të shtuar do të vlerësohet ndikimi dhe imazhi i pranimi i donacionit apo partneriteti me bizneset dhe fondacionet ndërkombëtare (brendet ndërkombëtare) të cilat mund të mos kenë imazh të mirë në Evropë dhe më gjerë.

3.3 Ekskluziviteti me partnerë

KOMF synon që përmes partnerëve të rrisë qëndrueshmërinë financiare të KOMF dhe anëtarëve të tij dhe njëkohësisht përmes partneritetit me biznese, fondacione apo individë me neto të lartë të promovojë edhe tek partnerët dhe punonjësit e tyre mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve. Prandaj KOMF nuk do të hyjë në partneritet me biznese, fondacione apo individë të cilat mund ta ndikojnë integritetin, pavarësinë dhe përmbushjen e misionit të KOMF.

KOMF nuk do të japë ekskluzivitet për asnjë biznes apo brend me të cilin mund të hyjë në partneritet apo nga të cilët mund të pranojë donacione. Dhënia e ekskluzivitetit për një biznes apo brand do të mund t'i pamundësonte KOMF pranimin e donacioneve nga brendet/bizneset e ngjashme dhe do të mund të ndikonte në integritetin dhe pavarësinë e KOMF. Njëkohësisht partneriteti apo pranimi i donacionit duke i dhënë ekskluzivitet vetëm një biznesi apo brendi do të mund ta bënte KOMF më të cenueshëm në rastet kur biznesi apo brendi mund të kishte vëmendje negative në media dhe publik. Veç të tjerash, dhënia e ekskluzivitetit për vetëm një biznes apo brend do të parandalonte KOMF dhe anëtarët e saj nga mbledhja e fondeve dhe përmbushja e misionit të saj.

Në ekspozimet publike lidhur me pranimin e donacionit apo partneritetin përmes marketingut të ndërlidhur me kauzë, deklaratave për shtyp, ngjarjeve të përbashkëta, komunikimeve në media sociale etj. do të komunikohet me qartësi nëse përfitues do të jetë KOMF apo anëtarët e tij p.sh “Biznesi X përkrah KOMF” apo “Biznesi x përmes partneritetit me KOMF përkrah X organizatën anëtare”.

3.4 Marrëveshjet e partneritetit/pranimit të donacionit

Të gjitha partneritetet apo pranimet e donacioneve nga biznese, fondacione, individë me neto të lartë (përfshihen format e tjera të mbledhjes së fondeve nga individët të cilët nuk hynë në kategori të individëve me neto të lartë dhe të cilët mund të ju përgjigjen fushatave për mbledhje të fondeve duke donuar vlera më të ulëta monetare) do të qeverisen përmes marrëveshjes mes KOMF dhe donatorit.

Në rastet kur donacioni do të jepet përmes KOMF për një nga anëtarët, partneriteti apo pranimi i donacionit do të qeveriset përmes marrëveshjes tre palëshe KOMF, donator dhe organizatë anëtare. Në këto raste në marrëveshje do të përfshihet një klauzolë e cila përcakton obligimet e organizatës anëtare për transparencë, raportim, dhe shfrytëzim të fondeve të marra në pajtim me marrëveshjen. Po ashtu KOMF do të përfshijë përgjegjësitë e saj nga çdo mosmarrëveshje apo keqpërdorim që mund të ndodhë gjatë ekzekutimit të marrëveshjes dhe KOMF do të jetë vetëm si palë ndërmjetësuese.

Të gjitha marrëveshjet me biznese, fondacione, individë me neto të lartë duhet të përfshijnë edhe një klauzolë lidhur me prejardhjen e donacionit, ku do të theksohet se donatori merr përgjegjësi dhe konfirmon që donacioni ka prejardhje nga burimet financiare ligjore. Kjo klauzolë do të përfshihet me qëllim të mbrojtjes së KOMF dhe anëtarëve të tij.

Biznesi, fondacioni apo individ me neto të lartë, përveç asaj çka është cekur më sipër në marrëveshje apo shtojcë, do të deklarojë që biznesi, fondacioni, individ me neto të lartë nuk është i përfshirë në shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirje të fëmijëve në punë, produkte seksuale, praktika të punës abuzive dhe eksploative të cilat janë në kundërshtim me Konventën për mbrojtje të fëmijëve, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Deklaratën e ILO-s për parimet fundamentale dhe të drejtat në punë, si dhe standardet dhe ligjet vendore të punëtorëve.

Veç të tjerash, marrëveshjet për pranim të donacionit apo partneritet me biznese, fondacione dhe individë me neto të lartë duhet të përmbajnë objektiva të qarta të partneritetit, rolet dhe përgjegjësi të qarta.

Për fushata me marketing të bazuara në kauzë, marrëveshjet mes KOMF dhe biznesit do të nënshkruhen para fillimit të fushatës dhe marrëveshja veç të tjerash do të përmbajë një klauzolë e cila përcakton shumën minimale e cila do të donohet si dhe kohëzgjatjen e fushatës.

4. Parimet udhëzuese të mbledhjes së donacioneve nga individët

Mbledhja e donacioneve nga individët konsiderohet të jetë ndër format të cilat japin qëndrueshmëri financiare për organizatat. Ekzistojnë disa mënyra, kanale dhe produkte përmes të cilave mund të mblidhen fonde nga individët. Individët mund të jenë donatorë sporadik – të cilët donojnë vetëm një herë, apo mund të jenë donatorë të përkushtuar – të cilët donojnë në mënyrë të rregullt. Donatorët individual sporadik apo të përkushtuar do të rekrutohen përmes mbledhjes së fondeve digjitale, F2F, apo fushatave të tjera.

Fondet nga individët do të mblidhen edhe përmes kutive të donacionit. Kutitë e donacionit do të vendosen vetëm në vende të sigurta dhe do të hapen në praninë e një komisioni prej së paku 3 anëtarëve.

Të gjitha donacionet nga individët do të mblidhen në xhirollogarinë bankare të KOMF apo përmes kutive të donacionit.

Duke patur parasysh që kur mbledhim fonde nga individët nuk kërkohen vlera të larta monetare të donacionit, parimet dhe standardet e përcaktuara për donatorët nga sektori i bizneseve, fondacioneve dhe individëve me neto të lartë nuk janë të nevojshme që të respektohen.

Në anën tjetër për të filluar mbledhjen e fondeve nga individët kërkohen disa parakushte të cilat e lehtësojnë mbledhjen e fondeve nga individët. Ne mesin e parakushteve të cilat janë të nevojshme për mbledhjen e fondeve nga individët janë: baza e të dhënave, metodat bankare të pagesave (procese bankare të automatizuara, kredit dhe debit kartela, procese të pagesave online), ueb faqja e zhvilluar me mundësi donimi online, mediat sociale, programet e lojalitetit.

Fushatat dhe aktivitetet për mbledhje të fondeve nga individët i drejtohen publikut të përgjithshëm. Megjithatë KOMF aktivitetet e mbledhjes së fondeve nga individët do t'i koordinojë me marrëdhëniet me publikun, me qëllim që të ketë sa më shumë përkrahës dhe të japë mesazhe në pajtim me misionin dhe vlerat e KOMF.

Megjithatë është e rëndësishme që secili individ pavarësisht vlerës të cilën e donon, të trajtohet me dinjitet. KOMF për të gjithë donatorët individual do të sigurohet, përveç në rastet kur nuk ka kontakte të donatorit individual, që të shprehë falënderimin e saj përmes e-mailit, mesazhit, telefonatës.

5 Rolet dhe përgjegjësitë

KOMF është përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve për mbledhje të fondeve, të ndërtojë raporte të mira me donatorët institucional, partnerët (bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë) në pajtim me vlerat dhe misionin e saj.

BORDI I KOMF

- Miraton drejtimin strategjik të KOMF për aktivitetet e mbledhjes së fondeve
- Miraton dhe monitoron planet dhe buxhetin për mbledhje të fondeve
- Siguron llogaridhënien dhe transparencën e KOMF

EKIPI I KOMF

- Siguron zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë për mbledhje të fondeve
- Punon drejt ngritjes së fondeve për të mbuluar shpenzimet e KOMF
- Përfshin komponentin e mbledhjes së fondeve në planifikimet e saj
- Promovon vizionin e donatorëve si partnerë përmes aktiviteteve të saj
- Inkurajon donatorët (bizneset, fondacionet, institucionet publike, donatorët institucional ndërkombëtare në vend dhe individët) të përkrahin aktivitetet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
- Siguron vlerësimin e rregullt të aktiviteteve të mbledhjes së fondeve
- Siguron mbrojtjen e imazhit të KOMF dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në aktivitetet për mbledhjen e fondeve
- Janë inovativë dhe kreativ në mbledhjen e fondeve
- Ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre për mbledhje të fondeve me organizatat anëtare
- Promovon tek anëtarët e saj format e ndryshme të mbledhjes së fondeve
- Promovojnë ndarjen e njohurive dhe përvojave në mes organizatave anëtare në mbledhje të fondeve

6. Udhëzime praktike

■ Logo dhe emri

Emri dhe logo e KOMF do të përdorën çdo herë me korrektësi dhe do të jenë të dukshme në të gjitha aktivitetet për mbledhje të fondeve dhe marrëdhënie me publikun të ndërlidhura me mbledhjen e fondeve.

Logo dhe emri i KOMF në fushatat për mbledhjen e fondeve do të përdoren në pajtim me parimet dhe vlerat e përcaktuara në pjesën 3.1. KOMF do të krijojë kanale dhe produkte të ndryshme të mbledhjes së fondeve për të rritur qëndrueshmërinë financiare në të cilat do të përdoret logo dhe emri i KOMF. KOMF do të tregojë kujdes të veçantë në përdorimin e logos në fushatat e marketingut të bazuar në kauzë.

■ Marrëdhëniet me publikun

Marrëdhëniet me publikun përveç përkrahjes së misionit dhe aktiviteteve të KOMF, do të përkrahin në mënyrë strategjike edhe aktivitetet për mbledhje të fondeve dhe do të synojnë promovimin e përkrahjes së aktiviteteve për mbrojtje të fëmijëve nga donatorët, përfshirë institucionet lokale dhe qendrore, institucionet ndërkombëtare, bizneset, fondacionet dhe individët.

Në aktivitetet e mbledhjes së fondeve dhe aktivitetet me marrëdhënie me publikun të ndërlidhura me mbledhje të fondeve, do të jepet një mesazh i qartë përmes të cilit publiku do të mund të behet pjesë dhe të kontribuojë në misionin dhe vlerat e KOMF. Veç të tjerash aktivitetet e marrëdhënieve me publikun të ndërlidhura me mbledhjen e fondeve, do të synojnë ruajtjen e imazhit dhe të maksimizojnë përpjekjet e KOMF për mbledhje të fondeve.

KOMF do të trajtojë me respekt konkurrentët e saj dhe nuk do të ndërmarrë veprime të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë e konkurrentëve të saj apo organizatave anëtare si dhe do të shmangë komentimin e aktiviteteve të tyre për mbledhje të fondeve në publik.

■ Organizatat anëtare

KOMF do të bashkëpunojë me organizatat anëtare të cilat kanë të zhvilluar kanalet e ndryshme të mbledhjes së fondeve, për të vlerësuar potencialin për mbledhje të fondeve dhe gradualisht për të krijuar infrastrukturën dhe stafin e nevojshëm për mbledhje të fondeve.

KOMF me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, do të ndajë përvojat më të mira me organizatat anëtare për mbledhje të fondeve dhe do të përkrahë iniciativat e organizatave anëtare për të ndarë përvojat e tyre brenda organizatave anëtare të KOMF.

■ Mbrojtja e fëmijëve

KOMF në çdo rrethanë dhe partneritet me bizneset, fondacionet, donatorët ndërkombëtarë, individët me neto të lartë dhe individët në përgjithësi, do të sigurojë që veprimet e tij të jenë në pajtim me Ligjin për Mbrojtje të Fëmijës, misionin, vlerat e KOMF dhe standardet e mbledhjes së fondeve.

KOMF në aktivitetet për mbledhje të fondeve, do të ruajë privatësinë e fëmijëve dhe rekomandon edhe organizatat anëtare të ruajnë privatësinë e fëmijëve në pajtim me Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve.

6.1 Hapat në mbledhje të fondeve nga bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë dhe individët

Për të mbledhur fonde nga bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë dhe individët, është e nevojshme të zbatohen disa hapa si në vijim:

- Mbledhja e të dhënave lidhur me potencialin për mbledhje të fondeve
- Identifikimi i karakteristikave e vendit
- Identifikimi i mediave dhe kanaleve të komunikimit
- Krijimi i kanaleve dhe produkteve për biznese, fondacione dhe individë .
- Krijim i listës/bazës së donatorëve (përfshirë bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë)
- Motivimi i donatorëve potencial për mbledhje të fondeve
- Vlerësimi dhe testimi se cilat kanale dhe produkte do të mund të realizohen dhe do të kthejnë investimin e bërë
- Përcaktimi i buxhetit për mbledhje të fondeve (përfshirë burimet njerëzore dhe infrastrukturën e nevojshme, si dhe investimi në fushata apo aktivitete për mbledhje të fondeve)
- Krijimi i besueshmërisë tek publiku përmes raporteve apo buletinit informativ për ndikimin e arritur
- Raportimi tek donatorët – raportet do t'u jepen partnerëve të cilët donojnë vlera më të larta përfshirë bizneset, fondacionet, individët me neto të lartë dhe donatorët institucional
- Aktivitetet e mbledhjes së fonde do të realizohen në pajtim me ligjet aktuale në vend

6.2 Etika në raport me Donatorët/partnerët – përdorimi i të dhënave

Donatorët mbajnë të drejtën për mospublikim, mos përmendje të emrit të tyre në komunikimin me publikun.

Donatorët mbajnë të drejtën për të mos u kontaktuar dhe për të kërkuar mos kontaktimin e tyre si dhe largimin e të dhënave të tyre nga lista/baza e donatorëve.

Të dhënat e donatorëve nuk do të ndahen me të tjerët përfshirë organizatat anëtare pa pëlqimin paraprak të donatorit.

Në rast të shkeljes së të dhënave të donatorëve apo hakimit të të dhënave të donatorëve, KOMF do të ndër marrë hapat e nevojshëm sipas ligjit për mbrojtje të të dhënave.

Shtojca 1.

Shembuj të pyetjeve të cilat ju ndihmojnë kur ballafaqoheni me raste sfiduese me partner (biznes, fondacion, individ me neto të lartë)

Shpeshherë ndodh që kapacitet e kufizuara të organizatave të pamundësojnë një hulumtim të kujdesshëm të partnerëve apo do të keni raste kur do të takoheni me partnerë të cilët nuk përfshihen në asnjërën nga kategoritë e përmendura më lartë. Më poshtë janë disa pyetje dhe udhëzime që mund tu ndihmojnë në marrjen e vendimit nëse do të pranoni donacionin apo hyni në partneritet me ta.

■ Pyetjet:

- A ka dhënë biznesi, fondacioni, individi me neto të lartë deklarata përmes të cilave ka qëndrime kontroverse për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me etikën, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e të drejtave të punonjësve etj.?
- Si perceptohet në publik imazhi i tyre kur krahasohet me të tjerët që veprojnë në të njëjtën fushë?
- A ka perceptim negativ në publik në nivel lokal apo nacional? (Këshillë: Një test të shpejt mund ta bën duke e përmendur emrin dhe kërkuar opinion për ta tek miqtë tuaj, familjarët, kolegët)
- A kanë patur partneritet me ndonjë OJQ tjetër?

■ Vlerësimi i rrezikut

Kurdo që jeni në kontakt me donatorë potencial (përfshijë donatorët institucional) për të cilët keni mëdyshje, para se merrni vendimin tuaj për bashkëpunim, shikoni se çfarë përfaqësojnë ata në vendin tuaj. Vendimi juaj për marrëveshje duhet të jetë i bazuar në nivelin e partneritetit dhe nivelin e angazhimit të partnerit (a do të jetë donacion i njëhershëm, fushatë me marketing të bazuar në kauzë, projekt 1 vjeçar, partneritet strategjik – më shumë se një vit) dhe duhet marrë vendimi duke patur në konsideratë pikat e mëposhtme:

- Niveli i rrezikut në tregun lokal apo nacional nëse hyni në partneritet apo pranoni donacion- kredibiliteti i partnerit.
- Vlera e donacionit dhe potenciali për impakt.
- Zhvillimet e fundit të tyre dhe nëse kanë treguar përmirësim apo prezantimi i tyre në media është përmirësuar.
- Niveli i komunikimit të jashtëm (Shënim: gjithnjë është ide e mirë ti diskutoni planet e komunikimit se çfarë niveli i komunikimit do të përfshihet).



Financuar nga
Bashkimi Evropian

